

University for Business and Technology in Kosovo

## UBT Knowledge Center

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

2009

### PARLAMENTI EVROPIAN

Flutur Kadrijaj

*University for Business and Technology - UBT*

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Law Commons](#)

---

#### Recommended Citation

Kadrijaj, Flutur, "PARLAMENTI EVROPIAN" (2009). *Theses and Dissertations*. 371.  
<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/371>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact [knowledge.center@ubt-uni.net](mailto:knowledge.center@ubt-uni.net).



## PUNIM DIPLOME

Studenti:  
Flutur Kadrijaj

Mentori:  
Emrush Ujkani

**TEMA: *PARLAMENTI EVROPIAN***

## HYRJE

Një punim diplome është një punim shkencor, që ka një strukturë dhe një qëllim të caktuar dhe përmes të cilit studenti edhe simbolikisht i përfundon studimet në një nivel të caktuar, në rastin tim, studimet bachelor.

Edhe unë jam përpjekur që në këtë punim t'i përmbahem disa rregullave formale dhe strukturore, e që bashkë me një përmbajtje të mirë, e bëjnë punimin më të plotë.

Në fillim jam munduar që të sjell disa informata dhe koncepte bazë për Parlamentin Evropian. Më pastaj jam përpjekur të bëj një ndërlidhje mes të institucioneve të bashkimit Evropiane dhe Kompetencave të tyre në të drejtën supranacionale.

Në pjesën e tretë, që është thelbi i temës së diplomës, kam shtjelluar në pika konkrete rolin ekzakt të Parlamentit Evropiane, të drejtat e Parlamentit Evropian, strukturën e Parlamentit evropian dhe gjitha autorizimet e komisionit evropian.

Shpresoj që i jam përmbajtur disa rregullave themelore dhe e kam bërë këtë punim aq të thjeshtë, sa që edhe dikush që nuk studion këtë fushë të jetë në gjendje të kuptojë thelbin dhe përmbajtjen e saj. Nëse këtë e kam arritur, jam i kënaqur dhe shpresoj që edhe ai që e lexon do të ndihet njëjtë!

## Përmbajtja

1. Hyrje.....	2
2. Parlamenti Evropian.....	3
2.1. Zhvillimi i Parlamentit Evropian.....	3
2.2. Funksionet e Parlamentit Evropian.....	4
2.3. Kompetencat e Parlamentit Evropian.....	6
2.4. Të Drejtat për Bashkëpunim.....	6
a. Dëgjimi i Detyrueshëm.....	8
b. Dëgjimi Fakultativ.....	8
c. E Drejta e Miratimit.....	8
3. Grupi i Dytë i Kompetencave të Parlamentit Evropian.....	9
3.1. Të Drejtat e Tjera të Parlamentit Evropian.....	10
4. Statusi dhe Mandati i Deputetëve.....	10
5. Mënyra e Vendimmarrjes.....	10
6. Rregullorja e Punës së Parlamentit Evropian.....	10
7. Akti Unik dhe Parlamenti Evropian.....	11
8. Traktati i Mاستrihtit dhe Parlamenti Evropian.....	11
9. Traktati i Amsterdamit dhe Parlamenti Evropian.....	12
10. Traktati i Nicës dhe Parlamenti Evropian.....	12
11. Traktati i Lisbonës.....	13
12. Parlamenti Evropian dhe Bundestagu gjerman.....	14
13. Konkluzioni.....	15
14. Literatura.....	16

## Hyrje

Tema që kam marrë në shqyrtim, është një temë mjaft e ndërlikuar për vetë faktin se Parlamenti Evropian fillon që me paraqitjen e tij me Traktatin e ESCS, gjegjësisht me Traktatin për Thëngjill dhe Çelik, edhe atë në nenin 21 të këtij Traktati dhe me nenin 107 të Marrëveshjes për Euroatom. Po ashtu neni 137 i Kontratës mbi Themelimin e Bashkësisë Ekonomike Evropiane, dhe me marrëveshjen e 25 Marsit të vitit 1957 për Organet e Përbashkëta të Bashkësisë Evropiane, parashihet ekzistimi i këtij institucioni. Në fillim Parlamenti Evropian u quajt Asamble, mirëpo ky term u braktis dhe fitoi termin standard Parlament. Rritja e kompetencave, roli dhe funksionimi i tij, vazhdimisht rriteshin. Vlen të theksohet Akti Unik Evropian i cili u nënshkrua në Luksemburg, u ratifikua nga parlamentet e shteteve antare më 1986 dhe hyri në fuqi më 1 Korrik 1987. Kompetencat legjislative të Parlamentit Evropian vazhdimisht rriteshin, më 1979 organizohen zgjedhjet e para të drejtëpërdrejta për deputetët e Parlamentit Evropian me mandat pesë vjeçar. Traktati i Mاستrihtit nga viti 1992 miratoi procedurën e bashkëvendimit, me të cilën Parlamentin e ka vendosur në pozitë të njëjtë me Komisionin. Traktati i Amsterdimit forcojë në mënyrë të konsiderueshme pjesëmarrjen e Parlamentit Evropian në procedurat legjislative të BE-së, ndërmjet përgjithësimit dhe thjeshtësimit të procedurave të bashkëvendimmarrjes.

Po ashtu, edhe Traktati i Nicës e forcojë rolin e Parlamentit Evropian si bashkëligjvënës, këto procedura u aplikuan edhe për çështje të tilla si: lufta kundër diskriminimit, kohezioni ekonomik dhe social, vizat, azili, imigrimi. Veç kësaj fitojë terren edhe e drejta në ankesë e Parlamentit Evropian në Gjykatën e Drejtësisë së Komunitetit Evropian.

## 2. PARLAMENTI EVROPIAN

Siç u tha më lartë Parlamenti Evropian është një organ i Bashkësisë Evropiane, puna dhe kompetencat e tij janë të definuara në pjesën e parë të Kreut të pestë të Kontratës mbi Themelimin e Bashkësisë Evropiane dhe në Rregulloren e vet të punës me të gjitha anekset dhe protokollet percjellëse, si dhe aktvendimin për futjen e zgjedhjeve të drejtëpërdrejta për deputetët e Parlamentit Evropian.

**2.1. Zhvillimi i Parlamentit Evropian-** E tërë ajo që është cekur në fillim lidhur me zhvillimin gradual të integritit evropian, gjegjësisht të Bashkësisë Evropiane, në njëfarë mënyre vlen sa i përket edhe zhvillimit të Parlamentit Evropian, i cili po ashtu ishte bërë në etapa të ndryshme, pra në mënyrë graduale. Fillimisht, Parlamenti Evropian në dispozitat e Kontratave Themeluese është quajtur Asamble, ky emërtim me prejardhje franceze nuk ishte i rastit, sepse iniciativa apo më mirë të thuhet koncepti për themelimin e Bashkësisë Evropiane vije nga ministri francez i punëve të jashtme Schuman, siç është përmendur, psh, në nenin 21 të Kontratës mbi Themelimin e Bashkësisë Evropiane për Thëngjill dhe Çelik, neni 107 i Kontratës mbi Themelimin e Bashkësisë Evropiane për Energjinë Berthamore, neni 137 i Kontratës mbi Themelimin e Bashkësisë Ekonomike Evropiane, si dhe Marrëveshja e 25 Marsit e vitit 1957 për Organe të Përbashkëta të Bashkësisë Evropiane. Mirëpo, kjo siç duket shkaktonte konfuzion pasi që në shumicën e gjuhëve të tjera emërtimi “Parlament” ishte sinonim i vetëm adekuat.

Kështu më 30 Mars 1962 nëpërmjet një akti juridik të burimeve sekondare u bë ndërrimi i emërimit nga Asamble në Parlament, emërtim që ky prej Gjykatës Evropiane të Drejtësisë u njoh zyrtarisht, e cila ishte edhe organi i vetëm që bëri këtë, ndërsa i detyrueshëm është bërë ky emërtim për të gjitha organet e Bashkësisë Evropiane, tek me hyrjen në fuqi të akteve unike evropiane, si akt juridik i burimeve primare. <sup>1\*</sup>

---

<sup>1\*</sup> Mr. Bashkim Zahiti, E Drejta Evropiane, 2003, fq-46

Pas transformimit prej Asambleje në Parlament, pason më vonë edhe një transformim funksional i cili karakterizohet me kalimin prej një Asambleje që përbëhet nga përfaqësuesit e parlamenteve nacionale të shteteve antare, në një parlament të zgjedhur në mënyrë të drejtëpërdrejtë, si dhe me një rritje të vazhdueshme të drejtave kontrolluese dhe bashkëvepruese. Ky zhvillim strukturor dhe funksional i Parlamentit Evropian ka bërë që të vie deri te krijimi i së Drejtës të Parlamentit Evropian, parimet e së cilës burojnë nga ato të parlamenteve nacionale të shteteve antare. Mirëpo, këtu duhet pasur parasysh se PE, për shkak të veçantisë dhe supranacionalitetit të Bashkësisë Evropiane ka një pozitë dhe funksion tjetër. Burimet e së drejtës të Parlamentit Evropian përbëhen nga burime primare dhe sekondare të Drejtës Evropiane, si dhe nga marrëveshjet institucionale, më pastaj këtu bëjnë pjesë edhe disa marrëveshje të shteteve antare lidhur me të drejtën për zgjedhje dhe mbi pozitën juridike të deputetëve të Parlamentit Evropian dhe Rregulloren e Punës së PE. <sup>2</sup>

## 2.2. Funksionet e Parlamentit Evropian

Parlamenti Evropian ka funksione të ndryshme, të cilat, nëpër periudha të ndryshme dhe kanë pësuar ndryshime, funksionet e PE në bazë të karakterit që kanë ndahen në tri grupe: 1.përfaqësimi i popujve të shteteve antare, 2. transmetimi i legjitimitetit të demokracisë, dhe 3. ekuilibri i forcave.

1. Parlamenti Evropian përbëhet nga përfaqësuesit e popujve të shteteve antare që janë të bashkuar në BE dhe i përfaqëson rrjedhimisht këta popuj. <sup>3</sup>

---

<sup>2</sup>\* Mr. Bashkim Zahiti, E Drejta Evropiane, 2003, fq-47

<sup>3</sup>\* [http:// www.mesohu.org/ 34623\\_parlamenti\\_evropian.html](http://www.mesohu.org/34623_parlamenti_evropian.html)



Që nga viti 1979 deputetët e PE, zgjedhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me votim të përgjithshëm çdo pesë vjet. Numri i deputetëve të Parlamentit Evropian nga çdo vend për vitin 2007/09 ishte: 1. Austria 18, 2. Belgjika 24, 3. Bullgaria 18, 4. Qiproja 6, 5. Republika e Çekisë 24, 6. Danimarka 14, 7. Estonia 6, 8. Finlanda 14, 9. Franca 78, 10. Gjermania 99, 11. Greqia 24, 12. Hungaria 24, 13. Irlanda 13, 14. Italia 78, 15. Letonia 9, 16. Lituania 13, 17. Luksemburgu 6, 18. Malta 5, 19. Holanda 27, 20. Polonia 54, 21. Portugalia 24, 22. Rumania 35, 23. Sllovakia 14, 24. Sllovenia 7, 25. Spanja 54, 26. Suedia 19, 27. Britania e Madhe 78. Sipas kësaj Parlamenti Evropian numëron 785 deputetë. Grupet politike të përfshira në PE, situata në tetor të vitit 2006 është si vijon: 1. E majta e bashkuar evropiane me 41 deputetë, 2. Grupi i socialistëve me 219 deputetë, 3. Të gjelbërit/ Aleanca e Lirë Evropiane me 42, 4. Pavarësia/ Demokracia me 28 deputetë, 5. Aleanca e Liberalëve dhe Demokratëve për Evropë me 103 deputetë, 6. Partia Popullore Demokratike ( Demokratët Kristianë) dhe Demokratët Evropianë me 278 deputetë, 7. Unioni i Kombeve për Evropë me 30 deputetë dhe 8. Deputetë të Pavarur dhe vende përkohësisht të lira deputetësh me 44 deputetë. 4

2. Parlamenti Evropian ka edhe funksionin e transmetimit të legjitimitetit demokratik, kjo përfshin legjitimitetin demokratik personal të organeve të veta dhe të organeve tjera të BE-së, si dhe legjitimitetin demokratik që e përbëjnë aktet e BE-së në nxjerrjen e të cilave është ai pjesmarrës.

3. Parlamenti Evropian, si funksion të vetin ka edhe ekuilibrin e forcave të veta në Union. Vet ekzistenca e tij është shprehje dhe element për ruajtjen e ekuilibrit të forcave të bashkimit. 5

---

4\* Paskal Fonten, Evropa në 12 Leksione, 2006, fq: 18-19

5\* [http:// www.mesohu.org/ 34623\\_parlamenti\\_evropian.html](http://www.mesohu.org/34623_parlamenti_evropian.html)

### 2.3. Kompetencat e Parlamentit Evropian

Në fillimet e veprimtarisë Parlamenti Evropian nuk kishte ndonjë domethënie të madhe në krahasim me parlamentet nacionale të shteteve antare. Kjo para së gjithash qëndron në atë se Parlamenti Evropian në disa fusha i mungojnë kompetenca me ndonjë domethënie të veçantë për kontrollin e Organeve Ekzekutive të BE-së. Në bazë të dispozitës të nenit 189, paragrafi i parë, fjalia e dytë e Kontratës mbi Themelimin e BE, Parlamentit Evropian i janë dhënë shprehimisht disa kompetenca. Pra këto kompetenca vlejnjë vetëm në lidhje me lëmitë e përcaktuara shprehimisht. Sipas karakterit që kanë kompetencat e PE ndahen në dy grupe, gjegjësisht në të drejtat për bashkëpunim dhe autorizimet për kontrollë.

### 2.4. Të drejtat për Bashkëpunim

I mundësojnë Parlamentit Evropian pjesëmarrjen aktive në procedurën e nxjerrjes së akteve unike, si dhe nëpërmjet kësaj atij i jepet mundësia të jetë në dijeni me aktivitetin legjislativ të OBE. Në bazë të nenit 192 paragrafi i parë i Kontratës mbi Themelimin e BE, Parlamenti Evropian ka të drejtë pjesëmarrje ( bashkëveprimi) në procedurën për nxjerrjen e akteve juridike të BE, për aq sa atij në bazë të Kontratës Themeluese i lejohet, sa edhe është i autorizuar që në kuadër të procedurave të parapara në nenet 251-252 të Kontrates mbi Themelimin e BE, të ushtrojë kompetencat e veta lidhur me bashkëveprimin.

Sipas formës së bashkëveprimit të Parlamentit Evropian, bashkëveprimet e tij i ndajmë në katër grupe: 1. të Drejtën e Bashkëvendimit sipas nenit 251 të Kontratës Themeluese, 2. të Drejtën e Bashkëpunimit sipas nenit 252, 3. të Drejtën e Dëgjimit dhe Deklarimit, si dhe 4. të Drejtën e Miratimit. <sup>6</sup>

---

<sup>6</sup>\* Mr. Bashkim Zahiti, E Drejta Evropiane, 2003, fq: 48-49

E Drejta e bashkëvendimit sipas nenit 251, të Kontratës mbi Themelimin e BE është sigurimi i një pjesëmarrje të denjë të Parlamentit Evropian në procedurën për nxjerrjen e akteve juridike të BE. Kjo pjesëmarrje e PE në pjesëmarrjen për nxjerrjen e akteve ligjore e thëllon legjitimitetin demokratik të normave juridike të BE.

Njëkohësisht kjo pjesëmarrje e denjë e PE, bën që këto norma juridike që nxirren në bazë të nenit 251 të Kontratës mbi Themelimin e Bashkësisë Evropiane të jenë akte të përbashkëta të PE dhe Këshillit, pasi për ligjshmërinë e tyre është i nevojshëm vendimi i këtyre dy organeve të BE-së. Procedura e bashkëvendimit gjen zbatim vetëm atëherë kur një normë e Kontratës Themeluese përcakton shprehimisht se për nxjerrjen e një akti juridik që ka të bëjë me një lëmi të caktuar është e nevojshme të përcaktohet procedura e bashkëvendimit sipas nenit 251 të Kontratës mbi Themelimin e BE. Një përcaktim i tillë pos tjerash gjendet edhe në dispozitat e neneve 40, 42, 46, 47, 94 të Kontratës mbi Themelimin e Bashkësisë Evropiane, i jep Parlamentit Evropian të drejtën e vetos së vërtetë parlamentare, pasi që në bazë të dispozitave të nenit 251, paragrafi i dytë, fjalia e 3b të Kontratës thuhet: ku për shkak të diferencave në mes Këshillit dhe Parlamentit Evropian. Parlamenti Evropian e refuzon me shumicë votash dhënien e pëlqimit këtij akti juridik nga Këshilli, ky akt juridikisht konsiderohet i pashpallur. Për këtë procedura e bashkëvendimit përbën edhe të drejtën më të rëndësishme të Parlamentit Evropian në pjesëmarrjen e tij për nxjerrjen e akteve juridike.

b. E Drejta e bashkëpunimit- Roli i Parlamentit Evropian në procedurën për nxjerrjen e akteve juridike të BE, është shumë më e vogël, në rast kur kemi të bëjmë me një procedurë sipas nenit 252 të Kontratës mbi Themelimin e Bashkësisë Evropiane. Edhe e drejta e bashkëpunimit gjen zbatim vetëm atëherë kur Kontrata Themeluese shprehimisht përcakton se për nxjerrjen e një akti përkatës ( p.sh. nxjerrjen e një akti juridik që ka të bëjë me nenet 99 paragrafi i pestë, 102 paragrafi i dytë, 103 paragrafi i dytë apo nenin 106 paragrafi i dytë i Kontratës mbi Themelimin e Bashkësisë Evropiane), është e nevojshme të zbatohet procedura e bashkëpunimit, neni 252 paragrafi i parë i Kontratës mbi Themelimin e Bashkësisë Evropiane. Parlamenti Evropian nuk mundet të pengojë nxjerrjen e një akti ligjor, por mundet të vështirësojë vetëm punën e Këshillit në nxjerrjen e aktit përkatës. 7

---

7\* Mr. Bashkim Zahiti, E Drejta Evropiane, 2003, fq: 49-50

c. E drejta e Dëgjimit dhe Deklarimit përbën të drejtën më të dobët të Parlamentit Evropian në pjesëmarrjen e procedurës për nxjerrjen e akteve ligjore të Bashkësisë Evropiane. Deklarimi logjikisht që vie gjithmonë pas dëgjimit si rezultat i tij kur kemi të bëjmë me të drejtën për dëgjim, atëherë duhet të dallojmë dëgjimin e detyrueshëm prej atij fakultativ.

#### a. Dëgjimi i Detyrueshëm

Me një dëgjim të detyrueshëm kemi të bëjmë gjithmonë kur hyn në një normë të Kontratës Themeluese është i përcaktuar shprehimisht. Dëgjimi i siguron Parlamentit Evropian të drejtën për deklaram lidhur me propozimet përkatëse që ka bërë Komisioni, para se të marrë vendim Këshilli. Nëse parlamentit nuk i jepet mundësia për dëgjim në ato raste në të cilat kjo është e detyrueshme në bazë të dispozitave të Kontratës Themeluese, atëherë nëpërmjet padisë mund të arrihet të Gjykata e Lartë Evropiane e Drejtësisë. Këtë akt juridik i cili është miratuar nga Këshilli të shpallë të pavlefshëm, për shkak të shkeljes së rëndë të procedurës në kuptimin e nenit 230 paragrafi i dytë i Kontratës mbi Themelimin e Bashkësisë Evropiane.

#### b. Dëgjimi Fakultativ

Nuk është i përcaktuar në dispozitat e Kontratës Themeluese, ai është gjithmonë i mundshëm dhe ka domethënie të vogël në krahasim me dëgjimin e detyrueshëm, pra ky varet nga vullneti i Parlamentit Evropian.

### c. E drejta e Miratimit

Kur në Kontratën Themeluese është paraparë miratimi nga Parlamenti Evropian, atëherë akti juridik mund të nxjerret vetëm me vullnetin e PE, pra këtu sikur në rastin e procedurës sipas nenit 251 PE ka të drejtën e vetos, e drejta e miratimit është përcaktuar shprehimisht, si. Psh, në dispozitën e nenit 214 paragrafi i dytë i Kontratës mbi Themelimin e Bashkësië Evropiane, që ka të bëjë lidhur me emërimin e Komisionit në nenin 300 paragrafi i tretë në lidhje me nenin 310 të Kontratës Themeluese e që ka të bëjë më Marrëveshjen e Asocimit, më pastaj në nenin 49 të Kontratës mbi Themelimin e BE. Sa i përket të drejtave të përbashkëta për bashkëpunim të Parlamentit Evropian në përgjithësi është për t'u cekur se PE nuk ka të drejtën për incimin e akteve ligjore, me përjashtim sa i përket normave për zgjedhjet, në bazë të nenit 190 paragrafi i katërt, fjalia e parë. Mirëpo, lidhur me të drejtën për incim Parlamenti Evropian të paktën në bazë të dispozitës të nenit 192 paragrafi i dytë i Kontratës Themeluese të BE, mundet ta ftojë dhe të kërkojë nga Komisioni që të veprojë lidhur me një çështje të caktuar.

### 3. Grupi i dytë i kompetencave të Parlamentit Evropian

Ka të bëjë më autorizimin për kontrollë, kur kemi të bëjmë me kompetencat e Parlamentit Evropian, atëherë duhet pasur parasysh se ai ka kompetenca të vogla në çështjet e kontrollit, sa i përket organeve ekzekutive të BE, në krahasim me ato të parlamenteve nacionale, kontrolli ka të bëjë mbi Komisionin dhe Këshillin. 8

---

8\* Mr. Bashkim Zahiti, E Drejta Evropiane, 2003, fq: 50-51

### 3.1 Të drejtat e tjera të Parlamentit Evropian

Përpos të drejtave që shtjelluam më lartë që kanë të bëjnë me kontrollin, Parlamenti Evropian ka të drejtë që vlen për t'u përmendur: e drejta për informim, e drejta për kërkesë që mund të bëhet me ¼ e deputetëve, e drejta për të krijuar një komision parlamentar, po ashtu Parlamenti Evropian ka të drejtën e padisë pranë Gjykatës së Lartë të Drejtësisë, në bazë të dispozitës të nenit 230 të Kontratës mbi Themelimin. 9

### 4. Statusi dhe Mandati i deputetëve

Deputetët e Parlamentit Evropian kanë mandat evropian, ata përfaqësojnë popullin e tërë Bashkësisë Evropiane, mandati i tyre zgjat 5 vjet. Deputetët e PE kanë imunitet diplomatik dhe idemnitet. Imuniteti u siguron mbrojtje nga ndjekja penale e organeve përkatëse, idemniteti u garanton një mandat të lirë dhe të pavarur.

### 5. Mënyra e Vendimmarrjes

Në përgjithësi Parlamenti Evropian në bazë të dispozitës të nenit 198 paragrafi i parë i Kontratës, vendimet e veta i merr me shumicë absolute dhe kjo nuk ishte përcaktuar ndryshe.

6. Rregullorja e punës së Parlamentit- PE, si çdo parlament tjetër rregullohet për kryerjen e aktivitetit të vet të jashtëm dhe të brendshëm, i ka përcaktuar në rregulloren e vet të punës. Në bazë të nenit 199 të Kontratës mbi Themelimin e BE, PE, e nxjerr rregulloren e punës, lidhur me këtë është e nevojshme shumica e antarëve të vet. 10

---

9\* Mr. Bashkim Zahiti, E Drejta Evropiane, 2003, fq- 53 10\* Mr. Bashkim Zahiti, E Drejta Evropiane, 2003, fq: 56-57

## 7. Parlamenti Evropian dhe Akti Unik Evropian

Akti Unik Evropian ( AUE) u nënshkrua në Luksemburg dhe u ratifikua nga parlamentet e vendeve antare më 1986, hyri në fuqi më 1 Korrik 1987. Rëndësia e këtij dokumenti qëndron se i dha dinamizëm dhe rriti rolin e Parlamentit Evropian, duke e mbushur atë me deficit demokratik që ishte vënë re në Komunitet. Nëpërmjet zgjerimit të kompetencave të parlamentit nga njëra anë, miratimi në parim i Parlamentit ishte i rëndësishëm, në momentet e miratimit të marrëveshjes të zgjerimit apo të asocimit të Komunitetit me vendet e tjera. Ndërsa nga ana tjetër fillimi i një procedure të quajtur “procedurë bashkëpunimi” e rriti pushtetin e parlamentit, duke forcuar njëkohësisht rolin e Komisionit si arbitër duke ruajtur fuqinë vendimmarrëse të Këshillit të Bashkimit Evropian. Kjo procedurë ka të bëjë me tregun e brendshëm, politikën sociale, kohezionin ekonomik dhe social, kërkimet dhe zhvillimin teknologjik. <sup>11</sup>

## 8. Traktati i Mاستrihtit dhe Parlamenti Evropian

Traktati i Mاستrihtit, nga viti 1992 e miratojë procedurën e bashkërendimit me të cilën Parlamentin e ka vendosur në pozitë të njëjtë me Këshillin, kur vendoset për korniza ligjore për një sërë çështjesh të rëndësishme siç janë: lëvizja e lirë e punëtorëve, tregu i brendshëm, arsimit, hulumtimet, ambienti jetësor, rrjeti transevropian, shëndetësia, kultura, mbrojtja e konsumatorëve, parlamenti ka fuqinë që të refuzojë legjislacionin e propozuar në këto sfera, nëse shumica e parlamentarëve votojnë kundër qëndrimit të përbashkët të Këshillit. Mirëpo, marrëveshja ka rregullore në të cilën parashihet procedura për pajtim. <sup>12</sup>

---

<sup>11</sup>\* [http:// www.bankofalbania.org/web/ Akti\\_unik\\_2221\\_1.php](http://www.bankofalbania.org/web/Akti_unik_2221_1.php)

<sup>12</sup>\* Paskal Fonten, Evropa në 12 Leksione, 2006, fq: 19-20

## 9. Traktati i Amsterdimit dhe Parlamenti Evropian

Traktati i Amsterdimit u nënshkrua në Amsterdam më 16-17 Qershor 1997 nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të 15 vendeve të BE, që arritën një marrëveshje politike, për një traktat të ri për Evropën. Ky traktat parashihte reforma institucionale para zgjerimit, forcoi në mënyrë të konsiderueshme pjesëmarrjen e Parlamentit Evropian në procedurat legislative të BE nëpërmjet përgjithësimin dhe thjeshtësimin të procedurave të bashkëvendimarrjes. Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Ministrave të Bashkimit Evropian i marrin vendimet së bashku dhe janë të barabartë në procesin e vendimarrjes për shumicën e akteve ligjore, e kryesisht ato që lidhen me qytetarin, punësimin, shëndetin, qarkullimin e lirë, kërkimin, barazinë, dhe barazinë në shpërblim. 13

## 10. Traktati i Nicës dhe Parlamenti Evropian

Traktati i Nicës u nënshkrua nga ministratë e punëve të jashtme të vendeve antare më 26 Shkurt 2001, ndërkohë që ratifikimin i tij në vende të ndryshme u realizua ose nëpërmjet miratimit në parlament ose me referendum, si rrjedhojë e këtij procesi hyri në fuqi më 1 Shkurt 2003, numri maksimal i deputetëve në PE u rrit nga 626 në 732, dhe shpërndarja e tyre sipas vendeve anëtare dhe atyre kandidate, procedurat e vendimmarrjes të PE u aplikuan si: në luftën kundër diskriminimit, kohezionit ekonomik, vizat, azili, imigrimi, veçse këtyre shënoi terren e drejta për ankim në Gjykatën Evropian të Drejtësisë. 14

---

13\* [http://www.bankofalbania.org/web/traktati\\_i\\_Amsterdimit\\_2326\\_1.php](http://www.bankofalbania.org/web/traktati_i_Amsterdimit_2326_1.php)

14\* [http://www.bankofalbania.org/web/traktati\\_i\\_Nicës\\_2256\\_1.p](http://www.bankofalbania.org/web/traktati_i_Nicës_2256_1.p)



## 11. Traktati i Lisbonës dhe Parlamenti Evropian

Traktati i Lisbonës si një dokument serioz, ku qartëson në mënyrë shumë të prerë, kompetencat, funksionimin e shumë institucioneve të Bashkimit Evropian, në mënyrë të posaçme rregullon edhe çështjet në funksionimin e Parlamentit Evropian. Parlamenti Evropian bënë përfaqësimin e interesave të qytetarëve evropian, jep kontributin e tij në sferën legjislative. Sipas Traktatit të Lisbonës Parlamenti Evropian do të ushtrojë funksione legjislative dhe bugjetore në bashkëpunim me Këshillin. Kjo do të thotë edhe kontrollin politik po ashtu, do të zgjedh edhe Presidentin e Komisionit Evropian. Ndikimi i Parlamentit Evropian është rritur në masë të madhe në sferën e lirisë, drejtësisë, politikat kryesore, aspektet kryesore të politikës bujqësore dhe vendimet e zbatimit të politikës komerciale. Roli i Parlamentit Evropian është prezent edhe në miratimin e bugjetit, pëlqimi i tij është i nevojshëm edhe për vendime të naryrës kushtetuese, si në emërimin e Komisionit, parlamenti evropian ka të drejtën e iniciativës në procedurën për rishikimin e Traktateve të përcaktuara në nenin 48 TEU. <sup>15</sup>

Çdo traktat i ri ia ka rritur pushtetin legjislativ Parlamentit Evropian, tani vendet antare të Parlamentit Evropian kanë një status të barabartë me Këshillin e Ministrave, në marrjen e vendimeve, për shumicën dërmuese të ligjeve të Bashkimit Evropian. Traktati i Lisbonës e bënë Parlamentin Evropian një institucion të fortë duke e sjellur 40 fusha të reja të bashkëpunimit brenda vendimit, procedurën, sipas të cilit Parlamenti Evropian ka të drejta të barabarta me Këshillin. Këto fusha përfshijnë, apo më mirë të themi se risitë e paraqitura janë: bujqësia, sigurimi i energjisë, emigracioni, drejtësia, punët e brendshme, shëndetësia, fondet strukturore, parlamenti fiton një rol të madh në miratimin e bugjetit dhe do të vendos për gjithë bugjetin. Shumë pushtet do të thotë më shumë përgjegjësi, dhe më shumë se kurrë do të ndihmojnë jetën e qytetarëve të Bashkimit Evropian, parlamenti në të gjitha aktivitetet e veta do të respektojë të drejtat themelore të qytetarëve evropianë në pajtim me Kartën e të Drejtave Themelore, që është mishëruar në Traktat. Parlamenti Evropian do të ketë rol në marrëdhëniet me institucionet e tjera të BE-së. Tash e tutje, rezultatet e zgjedhjeve për parlamentin evropian do të jenë lidhur drejtë përdrejtë me zgjedhjen e kandidatit për President të Komisionit. Komisioni i tërë, duke

përfshirë edhe përfaqësuesin e lartë të Bashkimit Evropian për punët e jashtme dhe sigurisë, ka nevojë për miratimin e parlamentit evropian për ta marrë detyrën, edhe në këtë vërëhet një përgjegjësi e fuqishme e PE. Traktati i Lisbonës do të rrisë aftësinë e Bashkimit Evropian dhe Parlamentin e saj për të vepruar kur Evropa dhe pjesa tjetër e botës po ballafaqohen me sfida të reja siç janë: globalizimi, ndërrimet demografike, terrorizmi, ngrohja globale, për t'i luftuar këto sfida Parlamenti ka përgjegjësi. Një tjetër risi që sjell Traktati i Lisbonës, është edhe e drejta e parlamentit për të propozuar traktatin e ri për Bashkimin Evropian.<sup>16</sup>

---

15\* Traktati i Lisbonës, fq:3 dhe 15

16\* <http://www.europarl.eu/parliament/public/>

## Parlamenti Evropian dhe Bundestagu Gjerman

Në Gjermani aplikohet regjimi parlamentar i cili dallohet nga shtetet tjera si pasojë e karakterit federal të këtij shteti. Për nga forma e qeverisjes Gjermani është model tipik i një republike parlamentare. Federalizmi gjerman paraqet modelin më të zhvilluar në Evropë dhe funksionon mbi bazën e ndarjes gjeografike dhe një decentralizimi federal. Pushteti shtetëror ndahet në mes Bundit dhe Landeve. Ligji Themelor përcakton tri lloje të kompetencave në raportet në mes landeve: legjislacioni ekskluziv i Bundit, legjislacioni i Landeve dhe legjislacioni konkurrues i Bundit dhe Landeve. Në kompetencë të Bundit (pushtetit federale) është miratimi i legjislacioni ekskluziv për çështjet e sovranitetit të vendit. Landet kanë kompetencë legjislative për çështjet lokale, legjislacioni konkurrues i mundëson pushtetit federal të mbrohet nga tendencat e krijimit të sistemeve kundërrthënëse ligjore. Pushteti shtetëror është i koncentruar në tri institucionet politike-parlamentin, presidenti federal dhe qeverinë federale.

### **Bikameralizmi federal**

Parlamenti gjerman ka karakter bikameral të përbërë nga dy dhoma: bundestagu (dhoma federale) dhe Bundesrati (këshilli federal) Deputetët e Bundestagut zgjidhen në zgjedhjet e përgjithshme të drejtpërdrejta me mandat prej 4 viteve. Bundesrati përbëhet prej 3,4 ose 5 përfaqësues të qeverisë në çdo land, varësisht nga madhësia e popullsisë. Vendimet në Bundesrat merren unanimisht nga përfaqësuesit e çdo landi të cilët emërohen dhe shkarkohen nga qeveria e landit përkatës, në të cilën bëjnë pjesë si ministra. Përpos këtyre dy dhomave në Gjermani ekziston edhe Asambleja federale e cila është e autorizuar për çdo 5 vjet të zgjidh Presidentin e Republikës Federale, në këtë asamble marrin pjesë deputetët së bashku me një numër të barabartë përfaqësuesish të caktuar me votim të fshehtë nga parlamenti i çdo landi. Epërsia e Bundestagut shfaqet sidomos në planin e drejtimit të pushtetit politik ku i takon e drejta e zgjedhjes së kancelarit dhe vota e

mosbesimit të tij, kjo epërsi vjen edhe në planin legjislativ. Bundesrati ka të drejtë të ushtroj veto vezulluese ndaj ligjeve të miratuara në Bundestagu, madje Ligji Themelor parashikon që pa pëlqimin e Bundesratit ligjet që i përkasin rregullimit të strukturës territoriale të landeve etj nuk mund të aplikohet në këto raste mund të thuhet se është veto absolute.

## **Presidenti federal**

Presidenti federal zgjidhet nga Asambleja Federale me mandat prej 5 viteve dhe me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat. Presidenti federal paraqet institucionin me ndikim të kufizuar politik. Presidenti Federal nuk ka të drejtë për të nxjerr dekrete dhe as për të shkarkuar Kancelarin federal i cili gëzon besimin e parlamentit. Presidenti federal shpall ligjet, i parashtron Gjykatës Kushtetuese çështje të ndryshme, ratifikon traktatet ndërkombëtare, emëron disa funksionar të lartë, po ndryshe nga sistemet tjera parlamentare nuk komandon me forcat e armatosura . Ai formalisht mund të propozon kandidatin për Kancelar, por në fakt kandidati për këtë funksion është lideri i partisë apo koalicionit që në parlament disponon me shumicën parlamentare.

## **Qeveria federale**

Qeveria federale përbëhet nga kancelari dhe ministrat federal. Kancelari konsiderohet si institucioni kryesor politik në regjimin parlamentar gjerman, zakonisht propozohet nga presidenti dhe zgjidhet nga Bundestagu me shumicë absolute. Ministrat federal në qeveri emërohen dhe shkarkohen nga Presidenti në propozim të Kancelarit Federal. Kancelari dhe ministrat federal kanë autorizime të gjëra ekzekutive dhe operative. Kancelari federal paraqet figurën kryesore politike i cili qeverisë me pushtetin shtetëror në Gjermani. Vetëm Kancelarit i përket e drejta që t'i propozoj Presidenti shpërndarjen e Bundestagut.

## 12. Konkluzioni

Parlamenti Evropian që nga fillimet e tij të paraqitjes ka pësuar ndryshime të vazhdueshme, në fillim nuk kishte kompetenca që janë tipike për parlamentin, dhe e bënin të dallonin shumë nga institucioni i parlamentit. E them këtë për arsye se në shtetet konkrete parlamentet kanë funksione dhe përgjegjësi të fuqishme. Vlen të theksohet kontrolli i parlamentit mbi organet e pushtetit ekzekutiv, me interes të veçantë mbi qeveri, që në raste më ekstreme edhe mund të kërkojë edhe mocionin e votëbesimit, që nënkupton edhe rrëzimin e qeverisë, e në fillim këto attribute Parlamenti Evropian nuk i kishte. Tashmë Traktati i Lisbonës, cili ka hyrë në fuqi i jep shumë funksione dhe përgjegjësi Parlamentit Evropian, dhe e bën njërin nga institucionet më të besueshme, më të fuqishme në krejt strukturën institucionale të Bashkimit Evropian.

### 13. Literatura

1. Mr. Bashkim Zahiti, E Drejta Evropiane, 2003
2. Paskal Fonten, Evropa në 12 Leksione, 2006
3. [http://www.mesohu.org/34623\\_parlamenti\\_evropian.html](http://www.mesohu.org/34623_parlamenti_evropian.html)
4. [http://www.bankofalbania.org/web/Akti\\_unik\\_2221\\_1.php](http://www.bankofalbania.org/web/Akti_unik_2221_1.php)
5. [http://www.bankofalbania.org/web/Traktati\\_i\\_Amsterdamit\\_2326\\_1.php](http://www.bankofalbania.org/web/Traktati_i_Amsterdamit_2326_1.php)
6. [http://www.bankofalbania.org/web/Traktati\\_i\\_Nicës\\_2256\\_1.php](http://www.bankofalbania.org/web/Traktati_i_Nicës_2256_1.php)
7. Traktati i Lisbonës, faqe:3 dhe 15
8. Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës